



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 07, datë 29. 06. 2023

“PËR NGRITJEN E KOMISIONIT KËSHILLIMOR PËR DHËNIEN E TITUJVE VENDORE TË NDERIT NË BASHKINË SKRAPAR”

Këshilli Bashkiak Skrapar, në zbatim të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, nenin 54, "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak", në zbatim të Ligjit Nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë", nenit 14, nenit 15, pika 1, gërma "a", pika 2, neni 17, pika 1, VKM- së Nr.861, datë 10.12.2014 " Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënie dhe medaljeve dhe titujve vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë", Kreu I, pika 2, ku përcaktohet se: "Komisioni ngrihet me urdhër të autoritetit përgjegjës çdo fillim viti kalendarik", dhe në zbatim të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak , neni 1, "Rishikimi i Akteve, Anulimi, Shfuqizimi dhe Ndryshimi i tyre"

VENDOSI:

1. Të ndryshojë pjesërisht përbërjen e Komisionit Këshillimor për Dhënie e Titujve Vendore të Nderit në Bashkinë Skrapar, vendimuar me VKB Nr. 12, datë 28. 02. 2023, "Për Ngritjen e Komisionit Këshillimor për Dhënie e Titujve Vendore të Nderit në Bashkinë Skrapar, si më poshtë:

Znj. Fatmira Hasko
Z. Shkëlqim Zaimi
Znj. Elsa Petritaj
Z. Enver Caka
Z. Pëllumb Guri

2. Komisioni Këshillimor për Dhënie e Titujve Vendore të Nderit në Bashkinë Skrapar i ngritur në zbatim të këtij vendimi do të ushtrojë kompetencat e tij për vitin 2023.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Këshilli Bashkiak Skrapar
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 12 - vota pro, vota kundër - s'ka , votë abstenim – s'ka.

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .



KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK
Elsa PETRITAJ

